**VENDIM**
**Nr. 539, datë 27.7.2016**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 662, DATË 8.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE PËRDORIM TË BASHKISË KUÇOVË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "d", 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, miratuar me vendimin nr. 662, datë 8.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Shtohen pronat me numrat rendorë 568, 569 dhe 570 në pronësi të Bashkisë Kuçovë, me destinacion kënd lojërash, gjithsej 1 (një) fletë, sipas lidhjes 1 dhe formularit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) Përmasat e pronës me numër rendor 402, me destinacion "fushë tenisi", zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Bashkisë Kuçovë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronave të përcak-tuara në pikën 1.

3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, Bashkia Kuçovë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**FORMULAR PËR INVETARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE**
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

**Bashkia Kuçovë**

Identifikoi: **Edmond Menaj** (Specialiste),
**Xhenisa Kostreni**(Specialiste).
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: **Ferdinand Putro**
(Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimi)
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: **Selfo Kapllani** (Kryetar i Bashkisë Kuçovë)
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KUÇOVË

**Fusha e përdorimit: Shtesa 1**

| 1<br>Nr rendor | 2<br>Zona Kadastrale Indeksi i hartës | 3<br>Nr pasurise | 4<br>Lloji i prones | 5<br>Emri i prones Adresa | 6<br>Sip. Totale e Prones (m²) | 7<br>Nga Sip Totale: Sa ndertese (m²) | 8<br>Funksioni per te cilen perdoret prona | 9<br>Institucioni/ Enti me pergjegjesi administrative | 10<br>Institucioni/ Enti perdorues, Statusi juridik i perdorimit | 11<br>Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 568 | 2310 F-5 | 7/148 | Lulishte | Truall Lgj nr 1, blloku "Tafil Skëndo" Bashkia Kuçovë | 2186.3 | - | Kënd lojërash për fëmijë | Bashkia Kuçovë | Bashkia Kuçovë | |
| 569 | 2310 F-5 | 7/149 | Rrugë | Truall Lgj nr 1, blloku "Tafil Skëndo" Bashkia Kuçovë | 217.2 | - | Kënd lojërash për fëmijë | Bashkia Kuçovë | Bashkia Kuçovë | |
| 570 | 2310 F-5 | 7/150 | Park | Truall Lgj nr 1, blloku "Tafil Skëndo" Bashkia Kuçovë | 3022.7 | - | Kënd lojërash për fëmijë | Bashkia Kuçovë | Bashkia Kuçovë | |

**FORMULAR PËR INVETARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE**
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

**Bashkia Kuçovë**

Identifikoi: **Edmond Menaj** (Specialiste),
**Xhenisa Kostreni** (Specialiste).
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: **Ferdinand Putro**
(Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimi)
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: **Selfo Kapllani** (Kryetar i Bashkisë Kuçovë)
(emër, mbiemër, pozicioni zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KUÇOVË

Fusha e përdorimit: Kulture

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri rendor | Indeksi i hartes Zona Kadastrale | Numri i pasurise | Lloji i prones | Emri i prones Adresa | Siperfaqe Totale e Prones ($m^2$) | Siperfaqe ndertese ($m^2$) | Funksioni per te cilen perdoret prona | Enti me pergjegjesi administrative | Enti perdorues, Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera |
| 402 | F-5 2310 | 7/102 | Fushe sporti | Fusha e Tenisit Lagja nr 1, blloku "11 Shkurti" B Kuçovë | 1243 | 95 | Kulture sport | Bashkia Kuçovë | Bashkia Kuçovë | |